



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 janar 2022

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Kërkesat e
Prokurorisë lidhur me Dëshmitarët e Propozuar të Mbrojtjes**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hysni Gucatit
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt
Tobi Kadman

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹ në zbatim të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) është ngarkuar me shqyrtimin e apelit të parashtruar më 16 dhjetor 2021 nga Nasim Haradinaj (“Haradinaj” ose “i akuzuari”),² kundër “Vendimit mbi Kërkesat e Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Propozuar të Mbrojtjes” (“Vendimi i Kundërshtuar”).³ ZPS-ja u përgjigj më 21 dhjetor 2021.⁴ Haradinaj u kundërpërgjigj më 29 dhjetor 2021.⁵

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 shtator 2020, Haradinaj u arrestua në Kosovë në bazë të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm.⁶ Ai u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave

¹ F00001, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 9 dhjetor 2021.

² F00003, Parashtrime të Mbrojtjes së Haradinajt në lidhje me Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-07/F00470, 16 dhjetor 2021 (konfidenciale) (“Apeli”). Më 9 dhjetor 2021, Paneli ndryshoi *proprio motu* afatet për dorëzimin e përmbledhjes së dosjes së apelit dhe urdhëroi Haradinajn që të dorëzonte apelin e tij deri më 16 dhjetor 2021, urdhëroi ZPS-në që të dorëzonte përgjigjen e vet, nëse kishte, deri më 23 dhjetor 2021, dhe Haradinajn që të dorëzonte kundërpërgjigjen ndaj përgjigjes së ZPS-së, nëse kishte, deri më 29 dhjetor 2021. *Shih* F00002, Urdhër për Ndryshimin e Afateve për Dorëzimin e Përmbledhjes së Dosjes së Apelit kundër Vendimit mbi Kërkesat e Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Propozuar të Mbrojtjes, 9 dhjetor 2021. Më 31 dhjetor 2021, Paneli duke vepruar *proprio motu*, riklasifikoi si konfidenciale shtojcat 1 dhe 3 të Apelit, që i ishin dorëzuar si publike, duke pasur parasysh se ato fillimisht kishin qenë konfidenciale. *Shih* CRSPD79, Urdhër për Riklasifikim në lidhje me IA006-F00003-A01 dhe IA006-F00003-A03, 31 dhjetor 2021 (konfidencial) (“Urdhri për Riklasifikim”).

³ F00470, Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Propozuar të Mbrojtjes, 3 dhjetor 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

⁴ F00004, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes së Haradinajt në lidhje me ‘Vendimin mbi Kërkesat e Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Propozuar të Mbrojtjes’, 21 dhjetor 2021 (konfidenciale) (“Përgjigja”).

⁵ F00005, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Mbrojtjes së Haradinajt, 29 dhjetor 2021 (konfidenciale) (“Kundërpërgjigja”).

⁶ F00016, Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4), 25 shtator 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si publik më 15 tetor 2020); F00012/A03/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Fletarrestimit për Nasim Haradinajn, 26 shtator 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 24 shtator 2020 dhe u riklasifikua si konfidencial dhe *ex parte* në të njëjtën ditë). *Shih gjithashtu* F00012, Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 24 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si publik më 9 tetor 2020).

të Specializuar në Hagë më 26 shtator 2020.⁷

2. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike dhe për vepra penale kundër rendit publik, të ndëshkueshme në bazë të Kapitujve II, XXXI, dhe XXXII të Kodit Penal të Kosovës, nr. 06/L-074 (2019) dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.⁸ Më 14 dhjetor 2020, ZPS-ja dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.⁹ Më 5 korrik 2021, pas Vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit në lidhje me Mocionet Paraprake¹⁰ dhe pas Urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për Dorëzimin e Aktakuzës së Korrigjuar,¹¹ ZPS-ja dorëzoi versionin e korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar.¹²

3. Më 12 korrik 2021, Haradinaj dorëzoi Dosjen Paraprake.¹³ Më 27 gusht 2021, Haradinaj dorëzoi parashtrime në lidhje me rëndësinë e pretenduar të dëshmitarëve të propozuar të tij.¹⁴

⁷ F00020, Njoftim i Pranimit të Nasim Haradinajt në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 26 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si publik më 15 tetor 2020).

⁸ F00074/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, 22 dhjetor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 11 dhjetor 2020, u riklasifikua si konfidencial më 24 shkurt 2021).

⁹ F00075/A01, Shtojcë 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, Aktakuza e Redaktuar, 14 dhjetor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 14 dhjetor 2020). *Shih gjithashtu*, për versionin e përdiktuar, F00075/A01, Shtojcë 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, Aktakuza, 14 dhjetor 2020 (rreptësisht konfidenciale, u riklasifikua si konfidenciale më 24 shkurt 2021).

¹⁰ F00007, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit në lidhje me Mocionet Paraprake, 23 qershor 2021 (“Vendimi i Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake”).

¹¹ F00244, Urdhër për Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kalendarit të Rishikuar për Herë të Dytë të Pjesës së Mbetur të Procedurës Paraprake, 23 qershor 2021.

¹² F00251/A01/RED, Aktakuzë me më Pak Redaktime, 4 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 5 korrik 2021) (“Aktakuza”).

¹³ F00260/RED, Parashtrim i Redaktuar Publik i Dosjes së Ndërmjetme Paraprake të Mbrojtjes së Nasim Haradinajt, 2 shtator 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 12 korrik 2021).

¹⁴ F00289, Parashtrim në lidhje me Dëshmitarët, 27 gusht 2021 (konfidencial, u riklasifikua si publik më 16 dhjetor 2021) (“Lista e Dëshmitarëve të Mundshëm”).

4. Më 15 shtator 2021, ZPS-ja kërkoi, ndër të tjera, që Trupi Gjykses II (“Trupi Gjykses”) t’i hiqte dëshmitarët e propozuar DW1250 dhe DW1251 nga lista e dëshmitarëve të mundshëm të Haradinajt për shkak se dëshmia e pritshme e tyre nuk ka lidhje me çështjen kundër të akuzuarit.¹⁵ Më 27 shtator 2021, Haradinaj iu përgjigj kërkesës për heqje duke argumentuar, ndër të tjera, se këta dëshmitarë të propozuar janë në gjendje të paraqesin prova të rëndësishme për mbrojtjen e “interesit publik”.¹⁶
5. Më 23 tetor 2021, Haradinaj dorëzoi një kërkesë për të shtuar një dëshmitar ekspert tjetër në listën e dëshmitarëve të mundshëm të tij, dëshmitarin DW1253.¹⁷ Më 9 nëntor 2021, Haradinaj dorëzoi aktekspertizën e DW1253-shit.¹⁸ Më 16 nëntor 2021, ZPS-ja dorëzoi kundërshtimin e vet ndaj pranimit të dëshmisë së propozuar të DW1253-shit.¹⁹ Më 22 nëntor 2021, Haradinaj iu përgjigj këtij kundërshtimi.²⁰
6. Më 26 nëntor 2021, Trupi Gjykses nxori një vendim me të cilin refuzoi mocionet e Mbrojtjes për hedhjen poshtë të akuzave sipas rregullës 130 të Rregullores.²¹ Më 29 nëntor 2021, Haradinaj dorëzoi listat e tij të dëshmitarëve dhe provave materiale, në përputhje me rregullën 119(2) të Rregullores.²²

¹⁵ F00312, Kërkesa të Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarët e Mbrojtjes, 15 shtator 2021 (konfidenciale, u riklasifikua si publike më 6 dhjetor 2021) (“Kërkesat për Heqje”), para. 1, 8-9, 11-15, 23.

¹⁶ F00330, Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesave të Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarët e Mbrojtjes, 27 shtator 2021 (konfidenciale, u riklasifikua si publike më 6 dhjetor 2021) (“Përgjigje ndaj Kërkesës për Heqje”), para. 20-27, 33-35, 43-47.

¹⁷ F00394, Kërkesë e Mbrojtjes për Shtimin e një Eksperti në Listën e Dëshmitarëve të Mundshëm, 23 tetor 2021 (konfidenciale, u riklasifikua si publike më 16 dhjetor 2021).

¹⁸ F00426, Parashtrim i Aktekspertizës nga Mbrojtja e z. Haradinaj, 9 nëntor 2021; F00426/A01, Shtojcë A e Parashtrimit të Aktekspertizës nga Mbrojtja e z. Haradinaj, 9 nëntor 2021 (konfidenciale). *Shih gjithashtu* F00003/A03, Shtojcë 3 e Parashtrimit të Mbrojtjes së Haradinajt në lidhje me Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-07/F00470, 16 dhjetor 2021 (u riklasifikua si konfidenciale më 31 dhjetor 2021) (“Aktekspertiza”).

¹⁹ F00438, Kundërshtim i Prokurorisë ndaj Dëshmitarit Ekspert 18 dhe Aktekspertizën e Propozuar nga Mbrojtja, 6 dhjetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 16 nëntor 2021).

²⁰ F00444, Përgjigje e Mbrojtjes së Haradinajt ndaj Parashtrimit F00438, 6 dhjetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 22 nëntor 2021).

²¹ F00450, Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Rrëzimin e Akuzave, 26 nëntor 2021.

²² F00461, Parashtrim i Mbrojtjes së Nasim Haradinajt sipas Rregullës 119, 21 dhjetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 29 nëntor 2021). *Shih gjithashtu* F00428, Urdhër për Planin e Punës dhe Caktimin e Afateve për Hapat e Tjerë të Procesit, 9 nëntor 2021, para. 17(a).

7. Më 2 dhjetor 2021, Trupi Gjykses mbajti konferencë përgatitore për Mbrojtjen, gjatë së cilës shpalli vendimin për mosdëgjimin e dëshmitarëve të propozuar DW1250, DW1251 dhe DW1253 (bashkërisht, “dëshmitarët e propozuar”) për arsye se: (i) Haradinaj nuk arriti të shpjegonte lidhjen e dëshmime të propozuara të DW1250-ës dhe DW1251-shit me çështjen; dhe (ii) dëshmia e propozuar e DW1253-shit lidhej me aspekte për të cilat Trupi Gjykses mund të vendoste vetë pa ndihmën e dëshmisë së ekspertit.²³ Më 3 dhjetor 2021, Trupi Gjykses nxori Vendimin e Kundërshtuar, ku shpjegonte, ndër të tjera, arsyet për refuzimin e dëgjimit të dëshmime të dëshmitarëve të propozuar.²⁴ Më tej, Trupi Gjykses bëri të ditur se “do të ishte i prirë që të miratonte” lejen për apel sipas rregullës 77 të Rregullores në lidhje me dy pikat në vijim (“Pikat”):²⁵

- (a) konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me mungesën e lidhjes me çështjen të dëshmime të propozuara të DW1250-ës dhe DW1251-shit dhe vendimin e Trupit Gjykses për mosdëgjimin e këtyre dëshmitarëve; dhe
- (b) konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me palejueshmërinë e dëshmisë së propozuar të DW1253-shit në bazë të rregullës 149 të Rregullores dhe vendimin e Trupit Gjykses për mosdëgjimin e këtij dëshmitari.²⁶

8. Më 6 dhjetor 2021, Haradinaj kërkoi leje për të apeluar konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me këto pika dhe konfirmoi se nuk kërkonte leje për të apeluar pika të tjera nga Vendimi i Kundërshtuar.²⁷ Më 7 dhjetor 2021, ZPS-ja bëri të ditur se nuk e

²³ Transkripti, 2 dhjetor 2021, f. 2105-2107.

²⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 80-82, 111-115, 127(b), (e).

²⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 120.

²⁶ *Shih gjithashtu* F00484, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470, 8 dhjetor 2021 (“Vendimi për Leje për Apel”), para. 16.

²⁷ F00474, Kërkesë e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesat e Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarët e Propozuar të Mbrojtjes, 6 dhjetor 2021 (“Kërkesë për Leje për Apel”), para. 2, 4, 6-8.

kundërshtonte kërkesën për leje për apel.²⁸ Më 8 dhjetor 2021, Trupi Gjykses miratoi kërkesën për leje për apel.²⁹

II. STANDARDI I VLERËSIMIT

9. Paneli i Gjykatës së Apelit miraton standardin e vlerësimit për apelet e ndërmjetme të vendosur në vendimin e vet të parë dhe të zbatuar në vijim.³⁰

III. ÇËSHTJE PARAPRAKE

A. RIKLASIFIKIMI I PARASHTRIMEVE TË PROTOKOLLUARA

10. Paneli konstaton se Vendimi i Kundërshtuar u protokollua si publik, ndërsa apeli, përgjigja dhe kundërpërgjigja u protokolluan si konfidenciale.³¹ Paneli rikujton se të gjitha parashtrimet e protokolluara në Dhomat e Specializuara duhet të jenë publike, përveç rasteve kur ka arsye të jashtëzakonshme për t'i mbajtur ato konfidenciale, dhe se palët duhet të dorëzojnë versione të redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve që i dorëzohen Panelit.³² Gjithashtu, Paneli thekson se ZPS-ja nuk kundërshton që përgjigja e saj të riklasifikohet si publike.³³ Rrjedhimisht, Paneli urdhëron palët që të dorëzojnë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre për apelin,³⁴ ose të bëjnë të ditur, me anë të një parashtrimi të protokolluar, nëse ato

²⁸ Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2238.

²⁹ Vendimi për Leje për Apel, para. 17-21.

³⁰ F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucati për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020 ("Vendimi i Apelit të Gucati"), para. 4-14. *Shih gjithashtu p.sh.*, F00008/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelet kundër Vendimit për Nxjerrje të Informacionit, 29 korrik 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 29 korrik 2021) ("Vendimi i Apelit në lidhje me Nxjerrjen e Informacionit"), para. 14.

³¹ *Shih gjithashtu më lart*, poshtëshënimi 2 në lidhje me Shtojcat 1 dhe 3 të Apelit.

³² *Shih p.sh.* Vendimin e Apelit në lidhje me Nxjerrjen e Informacionit, para. 15; Vendim mbi Apelet në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 13. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021), para. 9 (ku palët u nxitën që t'i dorëzonin versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të tyre sa më shpejt që të ishte e mundur, pa pritur urdhër për ta bërë një gjë të tillë).

³³ Përgjigja, para. 42.

³⁴ Konkretisht, Apeli (F00003); Përgjigja (F00004); Kundërpërgjigja (F00005). Kjo ka lidhje vetëm me parashtrimet e protokolluara themelore.

mund të riklasifikohen si publike brenda dhjetë ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.³⁵ Duke iu rikujtuar gjithashtu se çdo riklasifikim i parashtrimeve të protokolluara konfidenciale kërkon autorizim gjyqësor në përputhje me rregullën 82(3) dhe (5) të Rregullores,³⁶ Paneli i Apelit kërkon nga palët që t'u përmbahen rreptësisht këtyre kritereve.

B. ÇËSHTJE QË DALIN JASHTË KUADRIT TË PIKAVE TË AUTORIZUARA PËR APELIM

11. Paneli i Gjykatës së Apelit rikujton se shqyrtimi i tij kufizohet rreptësisht në pikat e autorizuara nga paneli i shkallës më të ulët.³⁷ Gjithashtu, Paneli rikujton kuadrin e kufizuar të pikave të autorizuara nga Trupi Gjyqësor.³⁸ Përpara se të trajtojë thelbin e apelit, Paneli do të shqyrtojë nëse apeli del jashtë kuadrit të pikave të autorizuara nga Trupi Gjyqësor.³⁹

12. Paneli thekson se, ndërsa në apelin e tij Haradinaj e pranon kuadrin e kufizuar të pikave të autorizuara,⁴⁰ ai po ashtu kundërshton konstatimet paraprake të Trupit Gjyqësor në lidhje me parashtrimin e tij se “anshmëria” etnike e pretenduar e Dhomave të Specializuara përbën “interes publik”.⁴¹ Paneli vëren se ZPS-ja parashtron se

³⁵ *Shih* rregullën 82(3) dhe (5) të Rregullores; KSC-BD-15, Udhëzues i Punës i Zyrës Administrative mbi Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019, neni 39(1).

³⁶ *Shih* Urdhri për Riklasifikim.

³⁷ Vendimi i Apelit në lidhje me Nxjerrjen e Informacionit, para. 17; Vendimi i Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 20.

³⁸ *Shih më lart*, para. 7.

³⁹ *Shih* Vendimi i Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 20.

⁴⁰ *Shih* Apeli, para. 5 (parashtron se pjesët përkatëse të Vendimit të Kundërshtuar gjenden në paragrafët 80-82 dhe 102-111). *Shih gjithashtu* Apeli, para. 3; Kundërpërgjigja, para. 3.

⁴¹ *Shih* Apeli, para. 15-29, që i referohen Vendimit të Kundërshtuar, para. 58. *Shih gjithashtu* Apeli, para. 38-39; Kundërpërgjigja, para. 22. Konkretisht Haradinaj në lidhje me këtë argumenton se: (i) të akuzuarit duket se kritikohen për provat e përfshira në dokumente, përmbajtjen e saktë të të cilave e di vetëm ZPS-ja; dhe (ii) ka “material voluminoz” që është nxjerrë tashmë nga ZPS-ja gjatë çështjes gjyqësore i cili “përcakton qartë” përfshirjen e autorëve serbë në krime, duke përfshirë persona të përmendur konkretisht me emra, ndonëse ZPS-ja nuk po kryen hetime kundër tyre. Gjithashtu, një pjesë e argumenteve të Haradinajt ka lidhje me mosnxjerrjen e dokumenteve, për të cilat Paneli beson se janë dokumentet e sekustruara Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 8, 17 dhe 22 shtator 2020 (*shih* Apeli, para. 18-20, 22, 74-75; Kundërpërgjigja, para. 12-14, 31-32). Kjo pikë, përveçse është jashtë kuadrit të pikave të apeluara pasi nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar, është shqyrtuar dhe zgjidhur tashmë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. *Shih*

argumente të tilla duhet të hidhen poshtë menjëherë sepse dalin jashtë kuadrit të pikave të autorizuara për apel, nuk kanë lidhje me Vendimin e Kundërshtuar dhe/ose kanë të bëjnë me çështje që në fakt nuk burojnë prej tij.⁴²

13. Paneli thekson se Trupi Gjykses nuk e autorizoi të akuzuarin të paraqiste ose të kërkonte pranimin e provave që synonin ta mbështesnin këtë pretendim. Gjithashtu, Paneli thekson se Trupi Gjykses miratoi një përkufizim të “interetit publik”, që e kufizon marrjen e provave në ato që do të sugjeronin se një pjesë e materialit që pretendohet se është nxjerrë nga i akuzuari përmban tregues të parregullsive në kontekstin e bashkëpunimit midis Republikës së Serbisë ose zyrtarëve të saj, dhe Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”) ose ZPS-së, të cilat do të kishin ndikuar në pavarësinë, paanësinë ose integritetin e hetimeve të TFHS/ZPS-së.⁴³ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se pretendimet e përgjithshme të bëra në apel për “anshmëri” etnike të Dhomave të Specializuara janë hedhur poshtë tashmë si elementë të argumentit mbrojtës të interesit publik të paraqitur nga i akuzuari. Për këtë arsye, Paneli gjykon se argumentet e Haradinajt për këtë pikë dalin jashtë kuadrit

F00141/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Nxjerrjen e Disa Dokumenteve Sekuestruar Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, 23 shkurt 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 23 shkurt 2021), para. 42, 44, 47(a) (ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se mosnxjerrja e këtyre dokumenteve është proporcionale dhe në pajtim me Rregulloren); F00172/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rëndësinë Materiale të Informacionit të Kërkuar në përputhje me Rregullën 102(3) dhe Çështje të Lidhura me Të, 15 korrik 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 prill 2021), para. 37-38; F00210/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesat dhe Kundërshtimet e Prokurorisë në bazë të Vendimit F00172, 15 korrik 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 26 maj 2021), para. 61-65. *Shih gjithashtu* Vendimi i Apelit në lidhje me Nxjerrjen e Informacionit.

⁴² Përgjigje, para. 26. Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se disa argumente shtesë të parashtruara nga Haradinaj duhet të hidhen poshtë përfundimisht sepse ai: (i) nuk arrin të përcaktojë gabimet që pretendon dhe se si çdo gabim do të kishte ndikuar thelbësisht në Vendimin e Kundërshtuar; (ii) vetëm sa përsërit argumente që ishin të pasuksesshme para Trupit Gjykses; (iii) keqinterpreton dhe nuk merr parasysh disa pjesë të fakteve dhe të Vendimit të Kundërshtuar; dhe (iv) nuk ofron referenca konkrete nga faktet dhe jurisprudenca. *Shih* Përgjigje, para. 1, 22-25, 27-28. Në kundërpërgjigje, Haradinaj pretendon se parashtrimet e ZPS-së për hedhjen poshtë menjëherë të Apelit janë të gabuara dhe të papabuzuara. *Shih* Kundërpërgjigje, para. 8-15, 37.

⁴³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 58-61.

të pikave të autorizuara, nuk do t'i marrë në shqyrtim këto parashtrime dhe i hedh poshtë ato zyrtarisht.

IV. DISKUTIM

14. Fillimisht, Paneli konstaton se bazuar në jurisprudencën tashmë të pranuar gjerësisht të tribunalëve penalë ndërkombëtarë, vendimet në lidhje me pranimin e provave trajtohen përgjithësisht si diskrecionale dhe se ndërhyrja e apelit në këtë aspekt përlligjet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.⁴⁴ Paneli gjykon se vendimi për pranimin apo mospranimin e provave në përputhje me rregullën 138(1) të Rregullores është, gjithashtu, vendim brenda diskrecionit të Trupit Gjykes kur bën vlerësimin e lidhjes me çështjen, autenticitetit dhe vlerës provuese të provave të paraqitura. Në këtë aspekt, Paneli rikujton se nëse vendimi që kundërshtohet është vendim diskrecional, pala duhet të provojë se paneli i shkallës më të ulët ka kryer një gabim të dukshëm, në kuptimin që vendimi: (i) është bazuar në një interpretim të pasaktë të ligjit në fuqi; (ii) është bazuar në një përfundim faktik qartësisht të pasaktë; ose (iii) është kaq i padrejtë apo i paarsyeshëm sa që përbën shpërdorim të diskrecionit nga paneli i shkallës më të ulët.⁴⁵

A. DËSHMITARËT E PROPOZUAR DW1250 DHE DW1251

1. Parashtrimet e palëve

15. Në lidhje me dëshmitarët e propozuar DW1250 dhe DW1251, Haradinaj argumenton se ai vazhdon të ketë mendimin se dëshmia e propozuar e tyre “ka lidhje të drejtpërdrejtë me rrethanat e çështjes”, përfshirë gjendjen mendore të të akuzuarit, dhe me argumentin mbrojtës të tij se çfarëdo veprimi i kryer prej tij ishte i përlligjur

⁴⁴ *Shih p.sh.*, ICTR, *Prosecutor v. Simba*, ICTR-01-76-A, Judgement, 27 November 2007 (“*Simba Appeal Judgement*”), para. 19; ICTR, *Prosecutor v. Bagosora et al.*, ICTR-98-41-AR93 and ICTR-98-41-AR93.2, Decision on Prosecutor’s Interlocutory Appeals Regarding Exclusion of Evidence, 19 December 2003, para. 11. *Shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-A, Judgement, 16 October 2007, para. 39.

⁴⁵ Vendimi i Apelit të *Gucatit*, para. 14; F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021, para. 14.

për shkak të interesit publik.⁴⁶ Gjithashtu, Haradinaj argumenton se dëshmitë e DW1250-s dhe DW1251-shit ofrojnë “informacion kontekstual thelbësor” lidhur me “pretendimet për ndikim të papërshtatshëm” mbi ZPS-në dhe/ose Dhomat e Specializuara nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (“EULEX”) dhe Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm (“EEAS”).⁴⁷ Më tej, Haradinaj nuk pajtohet me konstatimet e Trupit Gjykses se i akuzuari “nuk ka vënë në dukje ndonjë material të përfshirë në informacionin që pretendohet se u zbulua nga i akuzuari që të mbështetë pretendimin për ‘anshmëri’ të [Dhomave të Specializuara]”.⁴⁸ Haradinaj shton se rreziku që dëshmia mund të shkaktojë “turpërimin e institucionit, prokurorëve dhe gjykatësve, dhe/ose autoritetit emërues” nuk është bazë e mjaftueshme për ta përjashtuar këtë dëshmi.⁴⁹ Së fundi, ai pretendon se mospranimi i dëshmimeve të propozuara të DW1250-ës dhe DW1251-shit do të ishte “sulm i drejtpërdrejtë kundër drejtësisë së procesit”.⁵⁰

16. ZPS-ja përgjigjet se apeli është i mangët dhe duhet të hidhet poshtë menjëherë, ndër të tjera, sepse Haradinaj nuk paraqet gabimet e pretenduara prej tij dhe se si secili gabim do të kishte ndikuar thelbësisht në Vendimin e Kundërshtuar, dhe thjesht përsërit argumente që ishin të pasuksesshme para Trupit Gjykses.⁵¹ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se apeli duhet të hidhet poshtë si i pabazuar. Sipas ZPS-së, trupat gjykses kanë “kompetencë diskrecionale të konsiderueshme” që të përjashtojnë dëshmitë që nuk kanë lidhje me çështjen dhe për të mundësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të gjyqimit, dhe nuk ka asnjë gabim të dukshëm në ushtrimin e diskrecionit nga Trupi Gjykses në lidhje me DW1250-ën dhe DW1251-shin, pasi përmbajtja e

⁴⁶ Apeli, para. 12-15, 35-36, 47; Kundërpërgjigje, para. 17. *Shih gjithashtu* Apeli, para. 46, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 81 (ku parashtrrohet se dëshmitë e DW1250-s dhe DW1251-shit, në cilësinë e dëshmitarëve joekspertë, kanë lidhje me çështjen).

⁴⁷ Apeli, para. 33-34, 38, 40. Haradinaj përmend në veçanti se EEAS është autoriteti emërues si për Dhomat e Specializuara dhe për EULEX-in. *Shih* Apeli, para. 13, 34; Kundërpërgjigja, para. 20.

⁴⁸ Apeli, para. 16-29, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 58. *Shih gjithashtu* Apeli, para. 39; Kundërpërgjigja, para. 22. *Shih më lart*, para. 12-13, poshtëshënimi 41.

⁴⁹ Apeli, para. 37, 42; Kundërpërgjigja, para. 24. *Shih gjithashtu* Apeli, para. 41, 43.

⁵⁰ Apeli, para. 30. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigja, para. 23.

⁵¹ Përgjigja, para. 1, 22-25. *Shih gjithashtu më lart*, poshtëshënimi 42.

dëshmime të propozuara prej tyre nuk ndonjë ka lidhje të rëndësishme me këtë çështje.⁵² Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se insinuata e Haradinajt se konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me këta dy dëshmitarë bazoheshin në nevojën për të shmangur “turpërimin e institucionit” është e pabazuar.⁵³

17. Haradinaj kundërpërgjigjet se dëshmitë e propozuara tregojnë se, nga njëra anë, ekziston një lidhje ndërmjet EULEX-it dhe/ose Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe, nga ana tjetër, ndërmjet Dhomave të Specializuara dhe/ose ZPS-së.⁵⁴

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

18. Paneli thekson se Trupi Gjykses nuk i pranoi dëshmitë e propozuara të DW1250-ës dhe DW1251-shit për shkak se Haradinaj nuk demonstroi lidhjen e tyre me këtë çështje, përfshirë edhe me argumentin mbrojtës të “interesit publik”, pasi dëshmia e pritshme e tyre do të trajtonte proceset, funksionimin dhe sjelljen kundërvajtëse të pretenduar të EULEX-it, pa ofruar ndonjë lidhje të besueshme me hetimet e TFHS-së ose ZPS-së, kontaktet e ZPS-së me autoritetet serbe, ose proceset para Dhomave të Specializuara.⁵⁵ Më tej, Paneli thekson se në apel Haradinaj shtjellon më tej argumentet që ia parashtrori Trupit Gjykses për lidhjen e pretenduar me çështjen të dëshmime të propozuara të dëshmitarëve, pa identifikuar qartë ndonjë gabim të Trupit Gjykses dhe pa shpjeguar se si përfundimi i nxjerrë nga Trupi Gjykses mund të përbëjë keqpërdorim të diskrecionit.⁵⁶ Thjesht mospajtimi i apellesit me përfundimet e nxjerra nga një trup gjykses bazuar në faktet e disponueshme, ose me peshën që u ka dhënë ai faktorëve të caktuar, nuk mjafton për të provuar kryerjen

⁵² Përgjigjja, para. 1, 30-32, 34.

⁵³ Përgjigjja, para. 33, që i referohet Apelit, para. 37, 42.

⁵⁴ Kundërpërgjigjja, para. 18-21.

⁵⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 80-81. *Shih gjithashtu* Transkripti, 2 dhjetor 2021, f. 2105-2106.

⁵⁶ Disa nga argumentet e Haradinajt të parashtruara para Trupit Gjykses janë përsëritur në apel. *Krahaso p.sh.*, Apeli, para. 12, 14, 47 me Përgjigjen ndaj Kërkesës për Heqje, para. 33-35.

e një gabimi të qartë.⁵⁷ Për më tepër, kushti për vërtetimin e një gabimi të panelit të shkallës më të ulët është i ndryshëm nga kushtet për leje për apel sipas rregullës 77 të Rregullores.⁵⁸

19. Pas rishqyrtimit të deklaratave të DW1250-s dhe DW1251-shit,⁵⁹ është e qartë për Panelin se dëshmitë e propozuara të dy dëshmitarëve janë pretendimet e tyre në lidhje me EULEX-in, të cilat, pavarësisht se janë serioze, nuk kanë lidhje me Dhomat e Specializuara dhe këtë çështje. Pavarësisht nga fakti se EULEX-i i ofron mbështetje logjistike dhe operative Dhomave të Specializuara dhe faktit që Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS) është administrativisht autoritet emëruar si për EULEX-in, ashtu dhe për Dhomat e Specializuara,⁶⁰ Dhomat e Specializuara janë institucion i veçantë. Çka është më me rëndësi, sipas mendimit të Panelit, dëshmitë e propozuara, përmes referencave të kufizuara të tyre për Dhomat e Specializuara,⁶¹ nuk ofrojnë informacion të bazuar në fakte për Dhomat e Specializuara, ose për ZPS-në dhe paraardhësen e saj TFHS-në, dhe nuk paraqesin ndonjë lidhje që do t'i bënte pretendimet e DW1250-s dhe DW1251-shit kundër EULEX-it të rëndësishme për Dhomat e Specializuara.⁶² Sipas pikëpamjes së Trupit Gjykses, argumentet e

⁵⁷ *Shih p.sh.*, Vendimi i Apelit të *Gucatit*, para. 64 dhe jurisprudencën e cituar në të; KSC-BC-2020-06, F00005, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021, para. 47.

⁵⁸ *Contra* Kundërpërgjigje, para. 8, 11.

⁵⁹ *Shih* F00003/A01, Shtojcë 1 e Parashtrimit të Mbrojtjes së Haradinajt në lidhje me Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-07/F00470, 17 dhjetor 2021 (u riklasifikua si konfidenciale më 31 dhjetor 2021) (“Deklarata e dëshmitarit DW1251”); F00003/A02, Shtojcë 2 e Parashtrimit të Mbrojtjes së Haradinajt në lidhje me Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-07/F00470, 16 dhjetor 2021 (konfidenciale) (“Deklarata e dëshmitarit DW1250”).

⁶⁰ *Shih* Apeli, para. 13; Kundërpërgjigja, para. 20. *Shih gjithashtu* Apeli, para. 34, që i referohet deklaratës së dëshmitarit DW1251, para. 118-119.

⁶¹ *Shih* Deklaratë e dëshmitarit DW1251, para. 70, 111-112, 114-115, 118-119; Deklaratë e dëshmitarit DW1250, para. 44, 54, 88.

⁶² Natyra hipotetike e provave të propozuara në lidhje me Dhomat e Specializuara pranohet pjesërisht nga Haradinaj kur argumenton se DW1250 dhe DW1251 “janë të aftë të japin mendimin e tyre për çështje konkrete dhe të rëndësishme për sa i përket praktikave që *ka gjasa* të jenë miratuar nga ZPS-ja”. *Shih* Apeli, para. 32 (theksimi i shtuar). Gjithashtu, pretendimet e Haradinajt lidhur me deklaratat e kryegjykatësit të Trupit Gjykses gjatë periudhës së punësimit të tij në EULEX janë hedhur poshtë tashmë nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara. *Shih* F00272, Vendim mbi Kërkesën për Vetëterheqjen ose Heqjen e Gjykatësve, 6 gusht 2021; F00278, Vendim mbi Kërkesën për Rishikim të Vendimit mbi Vetëterheqjen ose Heqjen e Gjykatësve, 20 gusht 2021. *Shih gjithashtu* Apeli, para. 41, 43,

Haradinajt përkundrazi në disa raste keqinterpretojnë përmbajtjen e deklaratave të DW1250-ës dhe DW1251-shit.⁶³ Për pasojë, Paneli pajtohet me vlerësimin e Trupit Gjykses se dëshmitë e propozuara nuk kanë lidhje me çështjen.⁶⁴ Gjithashtu, Paneli pajtohet me Trupin Gjykses se dëshmitë e propozuara të këtyre dëshmitarëve nuk e mbështesin argumentin mbrojtës të “interetit publik” të Haradinajt siç është përkufizuar në mënyrë të ngushtë nga Trupi Gjykses, pasi nuk përbëjnë provë që do të sugjeronte se disa nga materialet që pretendohet se u nxorën nga i akuzuari përmbajnë tregues të veprimeve të papërshtatshme që ndodhën në kontekstin e bashkëpunimit midis Republikës së Serbisë, ose zyrtarëve të saj, dhe TFHS-së ose ZPS-së, të cilat do të kishin ndikuar në pavarësinë, paanësinë ose integritetin e hetimeve të TFHS/ZPS-së.⁶⁵

20. Një trup gjykses mund të refuzojë pranimin e dëshmive nëse nuk është demonstruar në mënyrë të arsyeshme lidhja e tyre me çështjen.⁶⁶ Paneli pajtohet me Trupin Gjykses se në fazën e pranimit të dëshmive, lidhja me çështjen vlerësohet në bazë të faktit nëse dëshmitë e propozuara kanë të bëjnë me elementet e veprës (veprave) penale ose me formën (format) e përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë ose me faktet dhe rrethanat e tjera juridikisht thelbësore për provat dhe argumentet e palëve.⁶⁷ Lidhur me këtë, Paneli mendon se dëshmitë e propozuara të

që i referohet deklaratës së dëshmitarit DW1250, para. 54-59; Deklarata e dëshmitarit DW1251, para. 101, 114. Gjithsesi, Paneli i Apelit nuk është instanca e duhur për të rishqyrtuar këto pika.

⁶³ *Shih p.sh.*, Apeli, para. 39-40.

⁶⁴ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 80.

⁶⁵ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 59-61, 81.

⁶⁶ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 42-43. *Shih gjithashtu* F00334, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore, 29 shtator 2021 (“Vendimi për Provat Jogojore”), para. 11, që citon ndër të tjera ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.13, Decision on Jadranko Prlić’s Consolidated Interlocutory Appeal Against the Trial Chamber’s Orders of 6 and 9 October 2008 on Admission of Evidence, 12 January 2009 (“Prlić et al. Appeal Decision”), paras 17, ICTR, *Prosecutor v. Bagosora et al.*, ICTR-98-41-T, Decision on Admission of Tab 19 of Binder Produced in Connection with Appearance of Witness Maxwell Nkole, 13 September 2004, para. 7; Rules 137(1) and 138(1) of the Rules.

⁶⁷ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 40-41, që i referohet Vendimit për Provat Jogojore, para. 11-12. *Shih gjithashtu p.sh.*, *Prlić et al.* Appeal Decision, para. 17; ICC, *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11-373, Decision on the Confirmation of Charges Pursuant to Article 61(7)(a) and (b) of the Rome Statute, 23 January 2012, para. 66; ICC, *Prosecutor v. Katanga and Chui*, ICC-01/04-01/07-2635, Decision on the Prosecutor’s Bar Table Motion, 17 December 2010, para. 16.

DW1250-s dhe DW1251-shit nuk kanë asnjë lidhje me akuzat e përfshira në Aktakuzë, apo me mbrojtjen e “interesit publik” sipas përkufizimit të Trupit Gjykses.

21. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit gjykon se Haradinaj nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses bëri gabim të dukshëm ose shpërdoroi diskrecionin e vet kur refuzoi pranimin e dëshmive të propozuara të DW1250-s dhe DW1251-shit dhe vendosi që mos t'i dëgjonte këta dëshmitarë.

B. DËSHMITARI EKSPERT I PROPOZUAR DW1253

1. Parashtrimet e palëve

22. Haradinaj argumenton se dëshmia e propozuar e DW1253-shit nuk është me natyrë të përgjithshme dhe se mendimi i Trupit Gjykses se kjo dëshmi ka të bëjë me aspekte për të cilat ai mund të vendosë vetë, nuk vlerëson se sa komplekse janë aspektet në shqyrtim,⁶⁸ ndër të cilat edhe përvoja dhe njohuritë e dëshmitarit për programit të specializuar kompjuterik të përdorur nga ZPS-ja.⁶⁹ Sipas Haradinajt, dëshmia e propozuar e DW1253-shit ishte e domosdoshme për shkak të dëshmive të paraqitura nga ZPS-ja në gjykim që tregonin “mungesë të plotë të procedurave dhe protokolleve, mbajtjes së dokumentacionit, kronologjisë së mbajtjes në ruajtje të materialeve, vijimësisë dhe standardeve profesionale”.⁷⁰ Gjithashtu, Haradinaj parashtron se nuk kërkohet që ai të ofrojë precedent se përse duhet të pranohen provat, vetëm se duhet të provojë lidhjen e tyre me çështjen, vlerën provuese dhe arsyet.⁷¹

23. Haradinaj argumenton më tej se dëshmia e DW1253-shit do ta ndihmonte Trupin Gjykses për të arritur në një përfundim dhe se lejimi i dëshmisë nuk do të cenonte kompetencat e Trupit Gjykses, ndërsa moslejimi i dëshmisë do ta pengonte

⁶⁸ Apeli, para. 51, 55-57, që i referohen Vendimit të Kundërshtuar, para. 107.

⁶⁹ Apeli, para. 59-60; Kundërpërgjigjja, para. 28-29.

⁷⁰ Apeli, para. 52, 58. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjja, para. 25-27, 30-34.

⁷¹ Apeli, para. 53-54.

Haradinajn që të mbështeste me prova “një element qendror” të mbrojtjes së tij.⁷² Haradinaj pretendon se DW1253 do të dëshmojë në lidhje me përputhshmërinë e proceseve të kontrollimit dhe sekuestrimit të zbatuar nga ZPS-ja me praktikat më të mira të hetimeve penale ndërkombëtare dhe nuk do të komentojë për ligjshmërinë e tyre.⁷³ Në fund, Haradinaj kundërshton sugjerimin e Trupit Gjykses se pjesa më e madhe e dëshmisë së DW1253-shit mund të paraqitet përmes parashtrimeve të Mbrojtësit, pasi dëshmia është e natyrës teknike dhe jo e natyrës ligjore.⁷⁴

24. ZPS-ja përgjigjet se, nëse në apel trajtohet themelësia,⁷⁵ konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me DW1253-shin nuk përmbajnë asnjë gabim të dukshëm dhe janë në përputhje me jurisprudencën përkatëse.⁷⁶ Sipas mendimit të ZPS-së, asnjë nga parashtrimet e Haradinajt nuk arrin të provojë lidhjen e dëshmisë së DW1253-shit me çështjen dhe komentet mbi përshtatshmërinë e procedurave të ZPS-së nuk mund ta ndihmojnë Trupin Gjykses, pasi Trupi Gjykses, ndryshe nga DW1253-shi, i ka të gjitha dëshmitë relevante në dispozicion.⁷⁷ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Haradinaj keqinterpreton dëshminë e propozuar të DW1253-shit, pasi, në kundërshtim me parashtrimet e tij, një pjesë e vogël e aktekspertizës përmban komente për veprimtarinë e ZPS-së të bazuara në një dokumentacion jo të plotë dhe aktekspertiza vlerëson ligjshmërinë e atyre proceseve.⁷⁸ Së fundi, ZPS-ja parashtron se

⁷² Apeli, para. 61-68. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjja, para. 35-36.

⁷³ Apeli, para. 69-72, 76, që i referohen Vendimit të Kundërshtuar, para. 108. Haradinaj nuk pranon që DW1253-shi nuk duhet të lejohet të japë mendimin e tij nëse procesi i kontrollimit ishte në pajtim me Rregulloren. *Shih* Apeli, para. 71.

⁷⁴ Apeli, para. 77-82, që i referohen Vendimit të Kundërshtuar, para. 110. Gjithashtu, Haradinaj kundërshton mbështetjen e Trupit Gjykses në një vendim të TPNR-së dhe parashtron se duhet të bëhet dallimi me situatën në këtë çështje gjyqësore. *Shih* Apeli, para. 79-80, që i referohen ICTR, *Prosecutor v. Nahimana et al.*, ICTR-99-52-[T], Decision on the Expert Witnesses for the Defence, 24 January 2003, paras 21-22.

⁷⁵ *Shih më lart*, poshtëshënimi 42, para. 16.

⁷⁶ Përgjigjja, para. 1, 35, 41.

⁷⁷ Përgjigjja, para. 36-37. *Shih gjithashtu* Përgjigjja, para. 38.

⁷⁸ Përgjigjja, para. 38, që i referohet Apelit, para. 55, 69.

konstatimi i Trupit Gjykes se dëshmia e propozuar e DW1253-shit lidhur me pika që mund të paraqiten përmes parashtrimeve të Mbrojtësit ishte konstatimi i duhur.⁷⁹

2. Vlerësimet e Panelit të Gjykatës së Apelit

25. Fillimisht Paneli vëren se, si me çdo provë tjetër të propozuar, edhe dëshmia e ekspertit duhet të ketë lidhje me aspekte juridikisht thelbësore të çështjes në mënyrë që të pranohet.⁸⁰ Paneli vëren se ndërsa Trupi Gjykes nuk duket se e ka konstatuar shprehimisht rëndësinë e dëshmisë së propozuar të DW1253-shit në tërësi, Trupi Gjykes pranon se, të paktën, disa aspekte të aktekspertizës, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me krahasimin e praktikave të ZPS-së me praktikat më të mira të hetimeve penale ndërkombëtare, mund të jenë me rëndësi.⁸¹ Paneli i Apelit gjykon se lidhja me çështjen e dëshmisë së propozuar e DW1253-shit është e natyrës së përgjithshme dhe e kufizuar vetëm në këtë aspekt.

26. Paneli thekson më tej se gjatë shqyrtimit të pranueshmërinë së një aktekspertize ose dëshmie të ekspertit, paneli, krahas bindjes se dëshmitari i propozuar ka kualifikimet e nevojshme për t'u konsideruar ekspert, duhet të përcaktojë se dëshmia e propozuar: (i) do ta ndihmonte panelin; (ii) përfshihet në fushën e ekspertizës së dëshmitarit; (iii) nuk cenon funksionet e panelit si gjykes përfundimtar i fakteve dhe ligjit.⁸² Në këtë çështje gjyqësore, Paneli vëren se ndonëse Trupi Gjykes pranoi se DW1253-shi është hetues penal "me përvojë dhe shumë i kualifikuar", ai refuzoi të pranonte dëshminë e propozuar të tij për arsye se ajo: (i) ka lidhje me pika për të cilat Trupi Gjykes mund të vendosë pa ndihmën e dëshmisë së ekspertit, ose ku mendimi i tij nuk do t'i shtonte gjë asaj që Trupi Gjykes mund ta vendosë bazuar në njohuritë

⁷⁹ Përgjigjja, para. 39-40, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 110.

⁸⁰ *Shih më lart*, para. 20. *Shih gjithashtu* Vendimi i Kundërshtuar, para. 62-63.

⁸¹ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 110.

⁸² *Shih* ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-1159, Decision on Defence preliminary challenges to Prosecution's expert witnesses, 9 February 2016 ("*Ntaganda* Decision"), para. 8; ICC, *Prosecutor v. Ruto and Sang*, ICC-01/09-01/11-844, Decision on Sang Defence Application to exclude Expert Report of Mr Hervé Maupeu, 7 August 2013, para. 12. *Shih gjithashtu* Vendimi i Kundërshtuar, para. 62-63 dhe referencat e cituara aty, poshtëshënimi 148.

dhe ekspertizën e vet; (ii) uzurpon në disa aspekte përgjegjësitë e Trupit Gjykses; dhe (iii) mund të paraqiten nga Mbrojtësi përmes parashtrimeve.⁸³

27. Paneli vëren se një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjes së aktekspertizës ofron mendimin e DW1253-shit mbi pajtueshmërinë me Rregulloren të procedurave të kontrollimit dhe sekuestrimit të ZPS-së.⁸⁴ Paneli pajtohet me përcaktimin e Trupit Gjykses se kjo do të përbënte vlerësim ligjor, që është përgjegjësi vetëm e Trupit Gjykses.⁸⁵ Në këtë kontekst, Paneli rikujton se Trupi Gjykses ka diskrecion që të mos pranojë dëshminë e një eksperti të thirrur për të dhënë dëshmi për aspekte ligjore.⁸⁶ Gjithashtu, Paneli pajtohet me Trupin Gjykses se pranimi i këtij aspekti të dëshmisë së propozuar të DW1253-shit do të uzurponte përgjegjësitë e Trupit Gjykses për vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të ZPS-së në përputhje me kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara.⁸⁷

28. Në lidhje me pjesën e mbetur të aktekspertizës, Paneli vëren se në këtë pjesë krahasohen veprimet e ZPS-së, siç u shpjegua nga dëshmitari W04841 i ZPS-së, me praktikën prokuroriale në gjykatat penale ndërkombëtare, kryesisht në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”), të cilat DW1253-shi i njeh mirë.⁸⁸ Paneli mendon se këto pika janë pjesë e ekspertizës së DW1253-shit. Paneli thekson më tej se qëllimi i dëshmisë së ekspertit është që të ofrojë njohuri të specializuara të cilat mund ta ndihmojnë gjyksesin e fakteve të kuptojë provat e paraqitura.⁸⁹ Sipas

⁸³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 106-111. *Shih gjithashtu* Transkript, 2 dhjetor 2021, f. 2106-2107.

⁸⁴ *Shih* Aktekspertiza, para. 26-28, 30-31 në masën që këta paragrafë, ose pjesë të tyre, përmendin mendimin e DW1253-shit mbi përputhshmërinë e proceseve të ZPS-së me Rregulloren.

⁸⁵ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 108.

⁸⁶ ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Judgement, 30 January 2015 (“*Popović* Appeal Judgement”), para. 79. *Shih gjithashtu* SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, SCSL-03-01-T, Decision on Defence Application to Exclude the Evidence of Proposed Prosecution Expert Witness Corinne Dufka or, in the Alternative, to Limit its Scope and on Urgent Prosecution Request for Decision, 19 June 2008, para. 22.

⁸⁷ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 108.

⁸⁸ *Shih* Aktekspertiza, para. 9-25, 27, 29, 31, në masën që këta paragrafë, ose pjesë të tyre, krahasojnë proceset e ZPS-së me këto praktika.

⁸⁹ *Popović* Appeal Judgement, para. 375; ICTR, *Prosecutor v. Nahimana et al.*, ICTR-99-52-A, Judgement, 28 November 2007 (“*Nahimana et al.* Appeal Judgement”), para. 198; *Simba* Appeal Judgement, para.

mendimit të Panelit, dhe në kundërshtim me konstatimet e Trupit Gjykses,⁹⁰ pikëpamja e DW1253-shit mbi praktikën, siç u dëshmuar nga W04841, që mbështetet në njohuritë dhe përvojën e tij me praktikën e TPNJ-së dhe praktikën e hetimeve penale ndërkombëtare, do ta ndihmonte gjyksesin e fakteve të kuptonte provat e paraqitura dhe kërkon ekspertizë përtej asaj që ka tashmë Trupi Gjykses.⁹¹

29. Duke pasur parasysh se, në masën e kufizuar sikurse u tha më lart,⁹² aktekspertiza ofron informacion të rëndësishëm që kërkon njohuri të specializuara, Paneli gjykon se pranimi i këtij aspekti të dëshmisë së DW1253-shit nuk do të uzurponte përgjegjësitë e Trupit Gjykses.⁹³ Gjithashtu, për të njëjtën arsye, Paneli nuk pajtohet me Trupin Gjykses se këto pika mund të trajtohen në mënyrë më të përshtatshme përmes parashtrimeve të Mbrojtësit.⁹⁴ Fakti se DW1253 shqyrtoi vetëm një numër të kufizuar dokumentesh kur bëri analizën e tij,⁹⁵ duke pasur parasysh se Haradinaj nuk i ka të gjitha materialet që ka ZPS-ja,⁹⁶ dhe se ai nuk ishte në gjendje që të kryente të njëjtën këqyrje të materialeve si W04841, sipas mendimit të Panelit, jo domosdoshmërisht e pengon DW1253-shin që të japë mendim si ekspert në lidhje me provat e paraqitura nga W04841.⁹⁷ Paneli mendon se kjo nuk përbën bazë të vlefshme për të mos pranuar dëgjimin e dëshmisë së propozuar të DW1253-shit, por është argument i fortë për t'i lejuar Haradinajt mundësinë për të kundërshtuar dëshminë e W04841-shit përmes një dëshmitari ekspert, dhe jo vetëm përmes marrjes së tij në

174; ICTR, *Prosecutor v. Semanza*, ICTR-97-20-A, Judgment, 20 May 2005, para. 303; *Ntaganda* Decision, para. 7.

⁹⁰ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 107 (ku Trupi Gjykses konstatoi se “DW1253 nuk duket se mbështetet në ndonjë lloj ekspertize – në kuptimin e njohurive ose përvojës – që Paneli nuk e ka tashmë”).

⁹¹ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 107.

⁹² *Shih më lart*, para. 25.

⁹³ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 108 (ku Trupi Gjykses konstatoi se “dëshmia e propozuar e DW1253-shit do të uzurponte, në disa aspekte, përgjegjësitë e Panelit” (theksimet janë shtuar)).

⁹⁴ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 110. *Shih gjithashtu Nahimana et al.* Appeal Judgment, para. 294 (ku synimi për të hedhur poshtë pjesë të ekspertizës duket se është faktor në favor të pranimi të dëshmisë së ekspertit).

⁹⁵ *Shih* Aktekspertiza, para. 24.

⁹⁶ *Shih gjithashtu më lart*, poshtëshënimi 41.

⁹⁷ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 109. *Shih gjithashtu* Përgjigja, para. 38.

pyetje nga pala kundërshtare dhe parashtrimeve përmbyllëse.⁹⁸ Si rrjedhojë, Paneli gjykon se vendimi i Trupit Gjykses për të përjashtuar të gjithë dëshminë e propozuar të DW1253-shit i kalon kufijtë e ushtrimit të arsyeshëm të kompetencës diskrecionale.

30. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses gaboi kur refuzoi pranimin e të gjithë dëshmisë së propozuar të DW1253-shit dhe vendosi që mos ta dëgjonte këtë dëshmitar. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit vendos që t'i prapësojë këto konstatime dhe të pranojë dëshminë e DW1253-shit vetëm për qëllimin e kundërshtimit të dëshmisë së dëshmitarit W04841 të ZPS-së.

V. VENDIM

31. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON pjesërisht Apelin;

PRAPËSON, pjesërisht, konstatimet e Trupit Gjykses për mospranimin e dëshmisë së propozuar të DW1253-shit dhe vendimin për të mos e dëgjuar këtë dëshmitar, duke qenë se dëshmia e tij synon të kundërshtojë dëshminë e dëshmitarit W04841 të ZPS-së, brenda parametrave të diskutuar në paragrafët 27-30 të këtij vendimi;

HEDH POSHTË pjesën e mbetur të apelit;

URDHËRON palët të paraqesin versione të redaktuara publike të parashtrimeve të protokolluara në lidhje me apelin që përmenden në paragrafin 10, ose të bëjnë të ditur, me anë të një parashtrimi, nëse këto parashtrime mund të riklasifikohen si publike brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit të këtij vendimi; dhe

⁹⁸ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 109-110.

URDHËRON Zyrën Administrative të bëjë riklasifikimin e parashtrimeve të përmendura në paragrafin 10, pasi palët të bëjnë të ditur se ato mund të riklasifikohen.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

E premte, 7 janar 2022

Në Hagë, Holandë